

**KONTRATË
SHITJE-BLERJE KUOTA KAPITALI**

Palët:

Zj. Nejla Stafa, e bija e Ylli, qytetare shqiptare, lindur më 20/02/1990, në Tiranë, Shqipëri, me letërnjoftim 032007497 me banim në Tiranë, Shqipëri, me shtetësi shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar (këtej e tutje referuar si Shitësi);

dhe

Zj. Ledina Stafa, e bija e Ylli, qytetare shqiptare, lindur më 20/01/1987, në Tiranë, Shqipëri, me letërnjoftim 035368617, me banim në Tiranë, Shqipëri, me shtetësi shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar (këtej e tutje referuar si Blerësi);

Shitësi dhe Blerësi individualisht referuar si "Pala" dhe bashkërisht referuar si "Palët"

Kushtet paraprake

- a) Shitësi Nejla Stafa zotëron 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë Language Solutions shpk, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legislacionit të Republikës së Shqipërise, me NUIS: L21931014G me seli në : Rruga Faruk S.Begolli, ndërtesa 9, hyrja 18, Apartamenti 20, Tiranë, Shqipëri (këtej e tutje Shoqëria);
- b) Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë dhe Blerësi dëshiron të blejë këtë kapital mbi bazën e kushteve dhe termave të mëposhtme.

**Neni 1
Kushtet paraprake**

Kushtet paraprake të mësipërme ashtu si dhe shtojcat (nëse ka) janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

**Neni 2
Objekti i kontratës dhe Cmimi**

1. Nëpërmjet kësaj kontrate Shitësi i shet Blerësit, të lirë nga cdo barrë apo detyrim apo nga ndonjë e drejtë tjeter dhënë për ndonjë palë të tretë, 100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë në këmbim të LEK 1,000(një mijë), cmim të cilin Palët pranojnë se është i drejtë dhe i arsyeshëm;
2. Blerësi blen kuotat e mësipërme të kapitalit themeltar të Shoqërisë duke u bërë ortak i vetëm i Shoqërisë;
3. Palët bien dakord se me transferimin e kuotave të kapitalit sipas pikës 1 në këtë nen, Blerësi do të ketë pronësi 100% (njëqind përqind) të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë;

4. Cmimi i shitjes do të paguhet pas transferimit të rregullt të kuotave dhe regjistrimin e Blerësit në Registrin e Shoqërisë në Qëndrën Kombëtare të Biznesit (QKB) si dhe pas marrjes së të gjitha masave të tjera të nevojshme për hyrjen në fuqi të këtij transferimi, por jo më parë se 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës;
5. Shlyerja e cmimit të shitjes do të kryhet nëpërmjet transfertës bankare në numrin e llogarisë IBAN- AL 4420811008000097214335102 Eur të Shitësit në bankën Intesa SanPaolo Bank.

Neni 3 **Transferimi i kapitalit**

1. Palët bien dakord se transferimi i kuotave të kapitalit do të ketë efekt ligjor nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate;
2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Blerësi gjëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuotat e Shoqërisë në Registrin Tregtar si dhe pranë cdo institucioni tjetër sipas legjislacionit në fuqi;
3. Menjëherë mbas nënshkrimit të palëve, kalimi i pronësisë së kuotave të Shoqërisë në favor të Blerësit do të regjistrohet në Qëndrën Kombëtare të Biznesit (QKB) në përputhje me Ligjin 9901/2008 të ndryshuar dhe me Ligjin 9723/2007 të ndryshuar.

Neni 4 **Deklarime dhe garanci të Shitësit**

Në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate, Shitësi deklaron dhe garanton se:

1. Kapitali i transferuar është i lirë nga cdo barrë apo detyrim apo nga ndonjë e drejtë tjetër dhënë për ndonjë palë të tretë, dhe se shitësi ka titull, të drejtë dhe kompetencë të plotë për të shitur dhe transferuar kuotat e kapitalit në përputhje me këtë kontratë;
2. I kalon Blerësit titull ligjor të plotë në lidhje me kuotat e kapitalit transferuar në përputhje me këtë kontratë;
3. Shitësi do të paguajë cdo taksë të aplikuar në lidhje me shitjen e kuotave të kapitalit sipas kësaj kontrate;
4. Shitja e kuotave në drejtim të Blerësit është kryer në pajtim të plotë dhe nuk bie në kundërshtim me ligjin tregtar në fuqi, dispozitat staturore të Shoqërisë, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekti të cilave është Shitësi.

Neni 5
Deklarime dhe garanci të Blerësit

Në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate, Blerësi deklaron dhe garanton se:

1. Ka autoritet dhe tagra të plota për të marrë pjesë në këtë kontratë sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në të;
2. Blerësi nuk ndodhet në procedurë falimentimi ose likuidimi dhe nuk ka ndonje rrezik që ti nënshtrohet këtyre procedurave;
3. Do të paguajë shpenzimet që lidhen me këtë kontratë, përfshirë shpenzimet bankare (nëse ka);
4. Blerja e kuotave nga Shitësi është kryer në pajtim të plotë dhe nuk bie në kundërshitm me ligjin tregtar në fuqi, dispozitat staturore të Shoqërisë, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjek i të cilave është Blerësi.

Neni 6
Trashëgimtarët apo përfituesit nga ndonjë kalim apo cedim

Kjo kontratë do të jetë detyruese apo në përfitim të Palëve dhe trashëgimtarëve apo përfituesve të tyre për shkak të ndonjë kalimi apo cedimi.

Neni 7
Ligji i zbatueshëm dhe Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kjo kontratë dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve do të rregullohen, interpretohen dhe zbatohen në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi;
2. Në rast mosmarrëveshje midis Palëve lidhur me interpretimin, ekzekutimin, shkeljen, përfundimin apo zbatimin e kësaj kontrate, Palët do të takohen dhe përpiken në mirëbesim të zgjidhin sa më shpejt që të jetë e mundur mosmarrëveshjen në fjalë. Nëse kjo mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet bisedimeve midis Palëve brenda 20 (njëzet) ditëve nga kërkesa e parë për takim, mosmarrëveshja do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 8
Dispozita përfundimtare

1. Kjo kontratë është hartuar në katër kopje, në katër faqe, me vlerë të njëjtë ligjore;
2. Palët deklarojnë se e kuptojnë kontratën dhe meqënëse kontrata është hartuar në përputhje me vullnetin e tyre dhe ligjin, e nënskruajnë personalisht kontratën pa vërejtje.

SHITËSI

Wjlla Shafiq

[Handwritten signature]



19. 02. 2020

BLERËSI

Leolina Shafiq

[Handwritten signature]

19. 02. 2020